



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PERGJITHSHEM / KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. dokumentit: 21.0.1-2010-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT VJETORE FINANCIARE TË ADMINISTRATËS SË
KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR VITIN E
PËRFUNDUAR ME 31 DHJETOR 2010**

Prishtinë, Qershor 2011

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
I. Hyrje	5
II. Opinioni i auditimit.....	6
III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara.....	6
IV. Buxheti i shpenzuar në krahasim me Buxhetin e aprovuar.....	8
V. Pasqyrat Vjetore Financiare.....	9
V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm	9
V.2 Cilësia e informatave	10
V.3 Shpenzimet.....	10
VI. Menaxhimi i kontrollit	15
VI.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm	15
VI.2 Auditimi i Brendshëm.....	16
VII. Konkluzion i përgjithshëm mbi Menaxhmentin e AKK-së	17
Shtojca I. Komentet e AKK-së dhe përgjigjja e ZAP-it	18
Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit.....	19

Lista e shkurtesave

AB	Auditimi i Brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
AK	Autoriteti Kontraktues
AKK	Administra e Kuvendit të Republikës së Kosovës
DT	Dosja e Tenderit
LMFPP	Ligji 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji nr.02/L-99 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar më 8 shkurt 2007. Përfshirë ligjin e ri, nr. 03/L-241 në fuqi prej 01 dhjetor 2010.
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe e Financave
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
OE	Operatori Ekonomik
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit(INTOSAI)
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
RTK	Radio Televizioni i Kosovës
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
UA	Udhëzim Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e Pasqyrave Vjetore Financiare, më tutje (PVF) të Administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës më tutje (AKK) për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga INTOSAI (SNISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një opinion lidhur me PVF-të.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të plotë dhe të drejtë. (ISSAI 400: *Opinion i pakualifikuar*)

Megjithatë kemi identifikuar dobësi në disa fusha të menaxhimit financiar. Këto dobësi janë të përshkruara më detajisht në brendësi të raportit.

Konkludimi ynë i përgjithshëm është se menaxhimi i procedurave të prokurimit nuk ishte bërë në përputhje me kornizën e aplikueshme ligjore. Kontrolli financiar nuk kishte arritur të parandaloj gabimet dhe parregullsitë e paraqitura në pagesa. Po ashtu mungesa e zyrtarit për pasuri kishte reflektuar me shënime jo të plota për pasuri në regjistrin përkatës.

Me qëllim që të përmirësohet funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontroleve të brendshme, ne rekomandojmë Kryetarin e Kuvendit të sigurojë që Sekretari i Përhershëm siguron rishikimin dhe analizimin e sistemit ekzistues të kontrollit brenda atyre fushave me mangësi të theksuara, në mënyrë që të siguroj llogaridhënie në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara.

Duke bërë këtë, vëmendje të veçantë duhet ti kushtohet:

- Adresimit të rekomandimeve tona;
- Analizimin e shkaqeve të ngecjes së realizimit të projekteve më kohë dhe të marrë masa për adresimin e tyre;
- Mjedis më transparent gjatë procesit të menaxhimit të prokurimit, duke filluar nga inicimi, nënshkrimi e deri te mbikëqyrja e kontratave;
- Përmes kontrollit financiar të parandalohen pagesat që nuk janë në përputhje me kontratën;
- Që regjistri i pasurive përmban shënime të plota me të gjitha karakteristikat e përcaktuara sipas kornizën ligjore përkatëse;
- Mbështetje të vazhdueshme të NJAB-së, njëherit të sigurohet se në planin e ardhshëm të saj të përfshijë më shumë aktivitetet e vitit aktual; dhe

- Që funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm eliminon të gjitha dobësitë që e përcjellin.

Menaxhmentit të AKK-së i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Menaxhmenti ka dhënë një numër komentesh të cilat i kanë qartësuar çështjet e ngritura dhe më pas janë ndryshuar.

Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe subjekti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, mund ti gjeni në Shtojcën 1.

Më tutje, menaxhmenti është zotuar që do t'i bëjë të gjitha përpjekjet për ti adresuar rekomandimet e dhëna.

I. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me PVF-të e AKK-së për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2010.

Është përgjegjësi e AKK-së të përgatis PVF-të sipas kërkesave të Udhëzimit Administrativ (UA) Nr.16/2010 dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNSKP) për “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”.

ZAP është përgjegjëse për kryerjen e auditimit vjetor të rregullsisë në institucionin tuaj.

Auditimi i rregullsisë përkufizohet si një verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e PVF-ve dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse PVF-të japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Kemi kryer auditimin e përkohshëm të AKK-së. Gjatë asaj faze kemi trajtuar rekomandimet e mëparshme si dhe cilësinë e menaxhimit financiar. Kemi këshilluar menaxhmetin për adresimin e çështjeve në PVF, përmes memorandumit të auditimit të dorëzuar në Dhjetor 2010.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona për auditimin e AKK-së, ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar PVF-të e AKK-së në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2010;
- Kemi përcaktuar nëse PVF-të e AKK-së janë përgatitur në pajtim me SNKSP “Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme”;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi PVF;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) në AKK.

Në raport, ne përmbledhim auditimin e këtij viti dhe japim një opinion formal mbi PVF 2010.

Lidhur me opinionin tonë për PVF-të e AKK-së, standardet ndërkombëtare të auditimit përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit që mund të jepet.

II. Opinioni i auditimit

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare në të gjitha aspektet materiale prezantojnë pasqyrim të plotë dhe të drejtë. (ISSAI 400: *Opinion i pakualifikuar*)

III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Në raportin e auditimit të vitit 2009 janë dhënë rekomandime në nëntë (9) fusha kryesore. Prej tyre, katër janë adresuar plotësisht, tre ishin në proces të adresimit ndërsa dy nuk ishin adresuar ende. Rekomandimet e implementuara nga AKK-ja janë:

- Të siguroj konsistencë në raportim në mes të PVF të vitit aktual me ato të viteve paraprake duke shpalosur ndryshimet e rëndësishme në mes të viteve. Të vazhdoj regjistrimin e duhur dhe me kohë të të gjitha pasurive jofinanciare në regjistrin kontabël si dhe paraqitjen e tyre të plotë në PVF;

- Të siguroj praktika të mira në menaxhimin e pagave brenda kornizës ekzistuese duke udhëhequr me shembuj të mirë që do të duhej të ndjekin të gjitha organizatat tjera të sektorit publik;
- Vendimet e brendshme të jenë në harmoni me udhëzimet e jashtme që tanimë ekzistojnë dhe i rregullojnë këto çështje për të gjitha institucionet publike; dhe
- Komisionet e formuara duhet të kryejnë një inventarizim të plotë dhe të pavarur nga çdo regjistër tjetër.

Rekomandimet në proces të implementimit janë:

- Është filluar me aplikimin e penaleve të kontraktuara për vonesat në kryerjen e punëve dhe pagesat për projekte kapitale janë duke u bërë në përputhje me kushtet e kontratës. Mirëpo, mbetet ende e pa implementuar çështja, që projektet kapitale të planifikohen, monitorohen dhe të realizohen në periudhë të përshtatshme të vitit që mjetet mos të rrezikojnë të mbeten suficit;
- Kontrole më të mira në menaxhimin e shpenzimeve dhe pagesave posaçërisht në fund të vitit, si dhe vendosjen e një sistemi funksional të kontrollit të brendshëm, duke kërkuar përgjegjësi dhe raportime në të gjitha nivelet e lartëpërmendura; dhe
- Auditori i brendshëm planin vjetor dhe aktivitet e auditimit i ka fokusuar në drejtim të fushës së Prokurimit dhe Menaxhimit të Pasurive si fusha me rrezik të lartë, mirëpo nevojitet që të kryehen auditime me mbulueshmëri më të madhe gjatë vitit aktual.

Edhe përkundër angazhimit të AKK-së, rekomandimet ende të pa implementuara janë:

- Forcimi i kontrollit të brendshëm para ekzekutimit të pagesave në mënyrë që kontrolli të verifikoj dhe parandaloj të gjitha faturat që kanë mospërputhje me specifikacionin teknik të kontratës; dhe
- Të ndërmerren veprime për të forcuar procedurat e prokurimit në fushat ku janë identifikuar dobësitë, si dhe nënkriteret të vlerësohen dhe peshohen drejtë sipas nevojës së AK-së për të rezultuar me përmbushje efektive të synimeve të organizatës.

Konkluzion

Nga kjo kuptojmë që adresimi jo i mjaftueshëm i rekomandimeve tona ka ndikuar që disa nga këto probleme të përsëriten edhe në këtë vit.

Rekomandimi 1

Ne rekomandojmë Kryetarin e Kuvendit të siguroj që Sekretari i Përhershëm:

- Është duke i kushtuar më shumë vëmendje adresimit të rekomandimeve tona, me qëllim të përmirësimit të menaxhimit financiar.

IV. Buxheti i shpenzuar në krahasim me Buxhetin e aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Vjetore Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar

Tabela 1: Përshkrimi i buxheteve dhe shpenzimeve (në €)

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Rishikuar	Buxheti Final	2010 Shpenzimet	2009 Shpenzimet
Grandi i Qeverisë – Buxheti	9,301,667	9,761,100	8,854,481	8,601,715	8,225,942
Donacionet jashtme	-	-	47,504	6,582	5,500
I. Gjithsej të hyrat dhe transferi i donacioneve	9,301,667	9,761,100	8,901,985	8,608,297	8,231,442
Pagat dhe Mëditjet	4,450,280	4,816,070	4,510,892	4,503,117	3,859,652
Mallra dhe shërbime	1,418,455	1,370,812	1,318,512	1,218,448	1,130,754
Shpenzimet komunale	163,500	241,208	203,511	202,011	220,100
Subvencionet dhe transferet	1,901,783	1,901,783	1,937,843	1,892,219	1,896,448
Investimet Kapitale	1,367,649	1,431,227	931,227	792,502	1,124,448
Rezervat	-	-	-	-	-
II. Gjithsej shpenzimet	9,301,667	9,761,100	8,901,985	8,608,297	8,231,442

Buxheti fillestar dhe ai rishikuar (kolona 1 dhe 2 e tabelës) paraqesin limitin e shpenzimeve të miratuar nga Kuvendi.

Nga të dhënat e prezantuara në tabelë shihet se me rishikimin e buxhetit në mes të vitit, buxheti i AKK-së ishte rritur. Kjo rritje e buxhetit kishte ndodhur si rezultat i vendimeve të marra nga Qeveria dhe AKK.

Rritja nga kategoria e Pagave dhe Mëditjeve ka ardhur si rezultat i vendimit të qeverisë për pagat e deputetëve që janë njëkohësisht edhe të emëruar politik. Në të parashihej që të gjithë të emëruarve politik qeveritar të cilët janë edhe deputet të AKK-së, për njërën pozitë do të marrin pagën e plotë, ndërsa për pozitën tjetër do të marrin 50% të pagës bazë. Gjithashtu rritja kishte ndodhur edhe për shkak të ngritjes së pagave me shtesë prej 30€ për muaj.

Zvoglimi i buxhetit në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve nga buxheti fillestar në atë me rishikim kishte ndodhur në bazë të vendimit të qeverisë për financimin e RTK-së.

Buxheti final në vlerë prej 8,901,985€, tregon një zbritje në raport me atë të rishikuar për 859,115€. Kjo zbritje ka ardhur si rezultat i kursimeve buxhetore dhe zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.

Shpenzimet e realizuara për vitin 2010 ishin 8,608,297€ apo 97% e kuotës së buxhetit final. Nëse i krahasojmë shpenzimet e ndodhura me buxhetin final sipas kategorive ekonomike, vërejmë realizim më të ulët të tyre (85%) në kategorinë e investimeve kapitale.

Shpenzimet për kategorinë e investimeve kapitale gjatë tërë vitit ishin 792,502€. Mirëpo vetëm në muajin Dhjetor shpenzimet për këtë kategori ishin 425,308 apo 54% të shpenzimit total. Kjo kishte ndodhur për shkak se procedurat e prokurimit për disa projekte ishin përsëritur gjatë vitit.

Konkluzion

AKK-ja kishte një realizim të mirë të buxhetit nëse e shohim si tërësi, përkatësisht 97% të buxhetit final. Mirëpo, nuk kishte shpenzim racional gjatë tërë vitit për investimet kapitale. Rritja e madhe e shpenzimeve në muajin Dhjetor rritë rrezikun për një menaxhim jo të mirë të parasë.

Rekomandimi 2

Ne rekomandojmë Kryetarin e Kuvendit të siguroj që Sekretari i Përhershëm:

- Analizon shkaqet e ngecjes së realizimit të projekteve më kohë dhe të marrë masa për adresimin e tyre.

V. Pasqyrat Vjetore Financiare

V.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm

Bazuar në kërkesat e LMFPP Nr. 03/L-048 dhe UA Nr. 16/2010, ne kemi identifikuar pikat si në vijim:

- AKK-ja i ka përgatitur PVF-të në pajtueshmëri me UA Nr. 16/2010;
- PVF-të janë nënshkruar nga personat përgjegjës, zyrtari kryesor administrativ dhe zyrtari kryesor financiar;
- Ato janë nënshkruar dhe dorëzuar në thesar brenda kornizës kohore me datën 31/01/2011. Megjithatë gjatë procesit të auditimit kemi vërejtur disa mangësi në informatat e prezantuara në PVF dhe kemi këshilluar AKK-në për përmirësimin e tyre. AKK është pajtuar dhe ka bërë korrigjimin e PVF-ve dhe të njëjtat janë dorëzuar në MEF me 17/03/2011;

- PVF-të janë pranuar vetëm në gjuhën shqipe;
- AKK-ja ka përgatitur dhe ka dorëzuar raporte të rregullta tremujore tek Ministri i MEF-it gjatë vitit 2010; dhe
- Në PVF është bashkangjitur edhe plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve të vitit të kaluar.

Konkluzion

Në përgjithësi AKK ka përgatitur si duhet PVF-të dhe ka përmbushur afatet ligjore në raportimin e jashtëm. PVF-të janë dorëzuar me kohë si dhe janë nënshkruar nga zyrtarët përgjegjës.

V.2 Cilësia e informatave

Ne kemi rishikuar informatat e prezantuara në PVF.

Ne kemi vlerësuar se informatat e prezantuara në PVF janë të sakta dhe të raportuara në mënyrën e duhur. Përfundimisht bën evidentimi i shpenzimeve, ku në tri raste nuk ishin regjistruar në kodet ekonomike adekuate brenda kategorisë së njëjtë të shpenzimeve.

Konkluzion

Përveç disa gabimeve gjatë regjistrimit të shpenzimeve në kode jo adekuate, të cilat nuk kanë ndikim material, informatat në PVF-të e AKK-së janë në pajtim me raportimin financiar dhe UA Nr.16/2010.

V.3 Shpenzimet

3.1 Blerjet përmes prokurimit

AKK-ja, për vitin 2010 kishte realizuar prokurime në vlerë prej 1,140,429€. Ne kemi testuar 11 lëndë në vlerë prej 500,958 € apo 44% e prokurimeve të realizuara. Në kuadër të këtyre shpenzimeve, testimet tona kanë shpalosur të gjeturat si në vijim:

Specifikimi teknik i përgatitur në mënyrë jo të qartë

Në dy raste kemi vërejtur që specifikacioni teknik i dosjes së tenderit (DT), nuk ka qenë i përgatitur në mënyrë të qartë në aspektin se çfarë kërkohet. Këto dobësi janë vërejtur te lëndët:

- “Servisim i rregullt i veturave Mercedes Benz”, ku specifikacioni teknik kishte një përshkrim të përgjithshëm si *servisim i rregullt*, duke mos specifikuar në detaje pjesët e servisimit apo shërbimeve të mundshme; dhe

- “Sanimi dhe gëlqerosja e hapësirave të brendshme”, ku është bërë vetëm një përshkrim i përgjithshëm si Lot I ‘Sanimi dhe gëlqerosja e ndërtesës së Kuvendit’ dhe Lot II ‘Furnizimi me material për ngjyrosje’. Në specifikacione është dhënë sasia totale e përafërt e punimeve prej 28,000 m², mirëpo nuk ishte specifikuar secili pozicion në veçanti.

Përzgjedhja e fituesit në mungesë të tre OE të përgjegjshëm

Në DT dhe në njoftimin për kontratë përcaktohen të gjitha kriteret e domosdoshme për të vlerësuar përgjegjshmërinë e ofertuesve që aplikojnë për kontratë.

Në dy raste, kemi vërejtur se janë përzgjedhur fituesit në mungesë të tri ofertave të përgjegjshme. Këto dobësi janë vërejtur te kontratat për:

- “Furnizim me kombibus”, në të cilin OE fitues nuk ka ofruar vërtetimin e Gjykatës që nuk është iniciuar procedurë penale për vitin 2010, siç ishte kërkuar. Në vend të saj si dëshmi kishte ofruar një vërtetim të vitit 2009 që nuk përkon me periudhën e tenderimit; dhe
- “Furnizim me llastop” që gjatë procesit të vlerësimit janë vlerësuar si të përgjegjshëm tre (3) OE. Njëri nga kriteret e përcaktuara nga AK-ja ishte kontratat e realizuara (minimum dyfishi i vlerës së ofertës që konkurron). Mirëpo, njëri nga OE edhe pse nuk kishte plotësuar këtë kriter ishte kualifikuar si i përgjegjshëm.

Mospërputhje midis çmimeve në faturë dhe kontratë

Çdo marrëveshje kontraktuale ndërmjet AK-së dhe OE-së kanë të determinuara të gjitha kushtet, karakteristikat dhe çmimet e shërbimeve.

Në katër raste, të cilat nuk janë materiale kemi vërejtur pagesa për furnizime apo shërbime të kryera që nuk janë në përputhje me ato të kontraktuara dhe që nuk kishin qenë as të përfshira në kontratë.

Dobësi në procesin e vlerësimit të ofertave

Në një rast, kemi vërejtur dobësi gjatë procesit të vlerësimit të ofertave. Kjo lidhet me kontratën për “Rregullimin e oborrit, traseve dhe parkingut në AKK”, në të cilin mungonte procesverbali për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve. Po ashtu është vlerësuar i përgjegjshëm OE, edhe pse nuk kishte ofruar listën e punëtorëve të përcjellur me raporte përkatëse.

Informatat kundërtënëse në dy ofertat për kuotim çmimesh

Në një rast “Furnizim me kompjuter”, kemi vërejtur që dy nga tre OE-të, në ftesën për koutim çmimesh, kishin të përziera informatat. Dokumente përcjellëse të çertifikatave të regjistrimit të biznesit e dy ofertuesve gjendeshin në ofertat e njëri tjetrit. Për të vërtetuar këtë ne kemi hapur kopjet e mbyllura të dosjeve të tenderit dhe të njëjtën gjë e kemi konstatuar prapë.

Ekzekutimi i pagesave me raporte jo të qarta mbi pranimin e shërbimeve

Te lënda “Sanimi dhe Gëlqerosja e hapësirave të brendshme të Kuvendit”, kemi vërejtur që janë ekzekutuar pagesa me disa raporte mbi punët e kryera, mirëpo që nuk ishin mirë të detajuara. Vlenë të theksohet që në një rast shuma e sipërfaqeve të raportuar nga komisioni, nuk përputhet me shumën në faturë.

Për më tepër në ofertën e OE fitues, kemi vërejtur që ishin lidhur pesë kontrata për mbikëqyrës të projektit për kontratën në fjalë dy muaj para se të publikohej njoftimi për kontratë nga AKK-ja.

Konkluzion

Ne konkludojmë që plani i prokurimit nuk është realizuar në nivelin e pritur. Edhe më tutje kontrolli mbi sistemin ekzistues të prokurimit nuk është tërësisht funksional. Ky sistem kishte dobësi prej fazës së inicimit e deri në fazën e ekzekutimit të kontratave.

Po ashtu kontrolli i brendshëm i pagesave nuk ka arritur të parandaloj gabimet e paraqitura. Kishte pagesa të pa kontraktuara ose jo në përputhje me kontratën. Kjo mund të dërgoj deri te një situatë ku blerjet, përkundër vlerës së parasë së dhënë të mos jenë të kualitetit të duhur.

Rekomandimi 3

Ne rekomandojmë Kryetarin e Kuvendit të siguroj që Sekretari i Përhershëm:

- Analizon dhe kërkon përgjegjësi në proceset e prokurimit, e në veçanti t’i kushtohet vëmendje kërkesave të LPP-së;
- Kërkon një sistem më të mbikëqyrur dhe më transparent të prokurimit për të siguruar procedura që rezultojnë me numër të mjaftueshëm të ofertave të përgjegjshme;
- Në dosjet e tenderit kërkon specifikime teknike të qarta, konkrete dhe të përshkruara në përputhje me kërkesat paraprake, duke detajizuar natyrën e shërbimeve që kërkohen; dhe
- Nëpërmjet kontrollit të brendshëm të pagesave, të parandalohen pagesat për shërbimet apo blerjet që nuk janë në pajtim me kushtet e kontratës.

3.2 Blerjet tjera

Në kategorinë e blerjeve tjera janë përfshirë të gjitha blerjet për mallra dhe shërbime, për të cilat nuk nevojitet të zhvillohen procedura të prokurimit.

Gjatë testimeve tona për këtë kategori të shpenzimeve, ne nuk kemi vërejtur ndonjë dobësi që do të vlente për tu theksuar në këtë raport.

3.3 Kompenzimet (pagat dhe mëditjet)

Në kategorinë e paga dhe mëditje në AKK hyjnë: anëtarët e Kuvendit (deputetët), Bordi i Pavarur Mbikëqyrës dhe administrata e Kuvendit. Bazuar në listën e pagave, numri i të punësuarve në AKK në muajin Dhjetor ishte gjithsejt 302.

Shpenzimet totale për paga dhe mëditje për vitin 2010 ishin 4,503,117€. Prej tyre nga buxheti janë 4,497,236€, ndërsa përmes donacioneve janë 5,881€.

Ne testuam dosjet e personelit dhe nuk kemi vërejtur ndonjë dobësi për tu theksuar në raport.

3.4 Subvencionet dhe Transferet

Subvencionet dhe transferet gjatë vitit 2010 ishin 1,892,219€, apo 22% e buxhetit final të AKK-së.

Në mbështetje të nenit 67.6 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Rregullores 6.8 të punës së AKK-së është marrë vendim për financimin e partive politike të përfaqësuara në AKK si dhe të grupeve parlamentare për vitin 2010.

Nga ky financim 95% të mjeteve i ndahen partive politike sipas numrit të vendeve të fituara në zgjedhjet për Kuvend dhe 5% për financimin e grupeve parlamentare.

Raportim jo i mirë i shfrytëzimit të subvencioneve nga partitë politike

Bazuar në memorandumit e mirëkuptimit me partitë politike, secila parti politike duhet t'i dorëzoj një raport detal të shpenzimeve për tremujorin paraprak sekretarit të AKK-së. Ky raport duhet të dorëzohet brenda tri javësh nga mbyllja e secilit tremujor. Në të kundërtën nuk do të bëhet transferi i mjeteve për tre mujorin e ardhshëm.

Gjatë periudhës tre mujore (Tetor, Nëntor dhe Dhjetor), vetëm 2 nga 27 subjektet politike kishin dorëzuar raporte tre mujore detale të shpenzimeve për këtë periudhë.

Konkluzion

Çështja e theksuar tregon se partitë nuk i janë përmbajtur memorandumit të nënshkruar me AKK për raportimin e shpenzimeve. Për shkak të mungesës së raportimit për shpenzimet e ndodhura ka munguar transparenca në subvencionet e dhëna partive politike.

Që nga fillimi i vitit 2011, partitë politike subvencionohen nga Këshilli Qendror Zgjedhor dhe për këtë arsye ato tani më nuk raportojnë në AKK.

3.5 Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Lista e pasurive të AKK-së e marrë nga thesari përmban një vlerë neto prej 7,171,383€. Ne kemi testuar katër fatura të pasurive me vlerë prej 305,872€ të cilat janë blerë gjatë vitit.

Testimet tona kanë shpalosur të gjeturat si në vijim:

Mungesa e zyrarit të pasurisë gjatë vitit 2010

Bazuar në vendimin e Sekretarit të Kuvendit nga Qershori i vitit 2007, përgjegjës për menaxhimin dhe regjistrimin e pasurisë ka qenë zyrtari i pagesave në Divizionin për Buxhet dhe Financa. Këtë detyrë zyrtari në fjalë e ka kryer deri në muajin Qershor të vitit 2010. Nga ky muaj i njëjti zyrtar kalon në pozitë të re në divizionin për mbështetje të komisioneve. Kuvendi nuk ka emëruar person të ri përgjegjës për menaxhimin dhe regjistrimin e pasurisë. Megjithatë gjatë periudhës kur ne kemi audituar është shpallur konkursi për këtë pozitë. Deri në plotësim të kësaj pozite është caktuar personi përgjegjës si ushtrues detyre.

Regjistri i pasurisë me shënime jo të plota

Kuvendi ka hartuar një regjistër të përgjithshëm të pasurisë, ku janë të evidentuara të gjitha pasuritë. Mirëpo, ky regjistër nuk i përmban të gjitha elementet e kërkuara sipas U.A Nr.21/2009 mbi menaxhimin e pasurive qeveritare.

Nga testimi i regjistrit të pasurisë kemi vërejtur se mungojnë elementet e kërkuara si: barkodi (numri serik), burimi i financimit, zhvlerësimi i akumuluar etj.

Konkluzion

Mungesa e zyrarit të pasurisë në Kuvend ka ndikuar që regjistri i përgjithshëm i pasurisë të mos jetë me shënime të plota. Kjo rezulton në një menaxhim jo të duhur të tyre.

Rekomandimi 4

Ne rekomandojmë Kryetarin e Kuvendit të siguroj që Sekretari i Përhershëm:

- Mbikqyrë dhe kërkon se regjistri i pasurive është me shënime të plota, ku pasuritë evidentohen me të gjitha karakteristikat e përcaktuara në kornizën ligjore përkatëse.

3.6 Borxhet

Pasqyra e obligimeve të pakryera ndaj furnitorëve në fund të vitit 2010 ishte në vlerë prej 42,060€.

Në bazë të faturave të prezentuara në PVF si obligime të bartura, vërejmë që shumica e tyre janë në fund të vitit, përkatësisht në muajin Dhjetor pas mbylljes së afatit për pagesë.

VI. Menaxhimi i kontrollit

VI.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Sistemi i mirë i kontrollit të brendshëm e ndihmon çdo organizatë buxhetore në arritjen e objektivave të përcaktuara në shfrytëzimin sa më të mirë të parave publike. Kjo do të siguronte raportim të besueshëm financiar.

Ne testuam në përgjithësi sistemin e kontrollit të brendshëm dhe identifikuam dobësitë në fushat në vijim:

- Dobësi gjatë menaxhimit të procedurave të prokurimit, sidomos gjatë procesit të vlerësimit dhe pranimi të mallrave dhe shërbimeve;
- Kontrolli i brendshëm i pagesave nuk kishte arritur të parandalojë pagesat jo në përputhje me kontratë; si dhe
- Shënime jo të plota në regjistrin e pasurive, si rezultat i mungesës së zyrtarit të pasurisë përgjatë tërë vitit.

Konkluzion

Nga kjo ne konkludojmë që AKK-ja nuk kishte vendosur kontrole të mira në menaxhimin e shpenzimeve të saj, në mënyrë që të parandalojë apo detektojë të gjitha gabimet dhe parregullsitë e mundshme. Në veçanti kishte dobësi në shpenzimet përmes prokurimit. Kjo mund të rezultojë me menaxhim jo të mirë të shpenzimit të parasë publike.

Rekomandimi 5

Ne rekomandojmë Kryetarin e Kuvendit të siguroj që Sekretari i Përhershëm:

- Përmirëson funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duke eliminuar të gjitha dobësitë që e përcjellin atë.

VI.2 Auditimi i Brendshëm

Në Planin vjetor të auditimit për vitin 2010, auditori i brendshëm (AB) kishte planifikuar pesë (5) auditime. Këtë përcaktim e kishte bërë në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe prioriteteve.

Gjatë periudhës në të cilën ne kemi audituar, AB kishte kryer 5 auditime, për të cilat kishte dhënë rekomandime me qëllim të përmirësimit të kontrollit të brendshëm.

Këto auditime kanë mbuluar:

- Fushën e prokurimit tri auditime, ku dy kanë mbuluar vitin 2009 dhe tremujorin e parë të vitit 2010, ndërsa një vitin 2010;
- Fushën e buxhetit, financave dhe menaxhimit të pasurisë, për periudhën e gjashtëmujorit të dytë të vitit 2009 dhe vitin 2010 në tërësi; si dhe
- Fushën e menaxhimit të personelit për vitin 2010.

Në kuadër të AKK-së është i themeluar edhe Komiteti i Auditimit i cili gjatë vitit për të cilin ne kemi audituar kishte mbajtur dy (2) takime.

Konkluzion

Në bazë të kësaj vijnë në konkludim që AB kishte përmbushur planin e auditimit duke dhënë konkluzione dhe rekomandime të qarta. Megjithatë periudha e auditimit në fushën e prokurimit kishte mbuluar më shumë vitin paraprak se atë aktual.

Rekomandimi 6

Ne rekomandojmë Kryetarin e Kuvendit të siguroj që Sekretari i Përhershëm:

- Ofron mbështetje të vazhdueshme NJAB-së, njëherit të sigurohet se në planin e ardhshëm të saj të përfshijë më shumë aktivitetet e vitit aktual.

VII.Konkluzion i përgjithshëm mbi Menaxhmentin e AKK-së

Bazuar në të gjeturat dhe konkluzionet e këtij raporti vijmë në konkludimin e përgjithshëm se menaxhmenti i AKK-së kishte një sistem të dizajnuar të kontrollit të brendshëm. Mirëpo, edhe përkundër këtij faktit, AKK-ja, në disa raste nuk kishte arritur që të siguroj implementim të mjaftueshëm të sistemit të kontrollit.

Menaxhimi i procedurave të prokurimit nuk ishte bërë në përputhje me kornizën e aplikueshme ligjore. Kontrolli financiar nuk kishte arritur të parandalojë gabimet dhe parregullsitë e paraqitura në pagesa. Po ashtu mungesa e zyrtarit për pasuri kishte reflektuar me shënime jo të plota për pasuri në regjistrin përkatës.

Duke u bazuar në konkluzionin e përgjithshëm rekomandojmë AKK-në si në vijim.

Rekomandimi i përgjithshëm

Ne rekomandojmë Kryetarin e Kuvendit të siguroj që Sekretari i Përhershëm siguron rishikimin dhe analizimin e sistemit ekzistues të kontrollit brenda atyre fushave me mangësi të theksuara, në mënyrë që të siguroj llogaridhënie në përputhje më detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara.

Shtojca I. Komentet e AKK-së dhe përgjigja e ZAP-it

Menaxhmentit të AKK-së i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij raporti. Menaxhmenti ka dhënë një numër komentesh të cilat i kanë qartësuar çështjet e ngritura dhe më pas janë ndryshuar. Çështjet e papërfunduara, për të cilat ne si auditorë dhe subjekti i audituar ende kemi pikëpamje të ndryshme, janë si më poshtë:

Kapitujt e Raportit	Pajtohëm	Pjesërisht pajtohëm	Nuk pajtohëm	Komentet nga AKK-ja	Përgjigjet e ZAP-it
2.1 Blerjet përmes Prokurimit					
<u>Të gjeturat:</u> <u>Specifikimi teknik i përgatitur në mënyrë jo të qartë (Sanimi dhe gëlqerosja e ndërtesës së Kuvendit)</u>			X	Operatorët janë informuar se ka rreth 28.000 m ² sipërfaqe për gëlqerosje. Kërkesa është bërë për njësi. Nga raporti i komisionit të pranimit të punëve shihet qartë se për çdo hapësirë të gëlqerosur, janë bërë matjet e sipërfaqeve të gëlqerosura (për çdo zyrë veç e veç). Furnizimet janë bërë sipas kërkesës së divizionit, ku komisioni i veçantë ka bërë pranimin e furnizimeve të materialit si dhe janë aprovimet për këto furnizime.	Mbetet e gjetura e auditorit, pasi që në specifikacionin teknik, ka pasur edhe pozicione si: pastrim, suvatim dhe gletim të pjesëve të dëmtuara, si dhe vendosje të lajsneve nëpër mure. Për të cilat ka mundur të përlllogaritet sipërfaqja e tyre.

Më tutje, menaxhmenti i AKK-së është zotuar që do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

Shtojca II. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit

(e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është një format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për të caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistente (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë në përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar;
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. Theksi i çështjeve. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si; nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) Ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit;
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo complete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. Opinion i Kualifikuar. Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar. Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajtimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar.

I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. Opinion i Kundërt. Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinionit. Aty ku Auditori nuk mund të jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksionit të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bënë të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ISA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.